



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërguar Punëpunësi / Prillog Received / Delivery	26.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SRKMSHCK	7666/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1398/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1398/2023 të datës 09.11.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat me adresë rruga Komuna e Prishtinës, kundër vendimit me Nr.01/XI/2023 të datës 02.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1398/2023 e datës 09.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet Vendimi me numër Nr.01/XI/2023 i datës 02.11.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, masa disiplinore “*Ndalimi i njëzet për qind (20%) të pagës bazë për një periudhë katër (4) muaj*”.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale dhe regjistri përkatës i nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën **II** të dispozitivit dhe ti bëjë kompensimin e diferencës së pagës 20% të pagës bazë e cila është ndaluar nga data 02.11.2023 e deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit me numër Nr.111 të datës 26.11.2013 në pozitën “Zyrtar i Prokurimit” në Departamentin e Prokurimit, në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, më datë 02.11.2023 me numër Nr.01/XI/2023 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore “Ndalimi i njëzet për qind (20%) të pagës bazë për një periudhë katër (4) muaj”, me arsyetimin se: Komisioni Disiplinor, duke ju referuar shkresës me nr. prot. 05-6098 datë 02/10/2023 të z. B.M. Ud. Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, (në tekstin e mëtejme, inicuesi i procedurës disiplinore), ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor (në tekstin e mëtejme Komisioni) që të zhvillohet procedurë disiplinore ndaj me pretendimet se ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës, që bien në kundërshtim me rregullat për veshjen dhe paraqitjen e nëpunësve civil, si dhe neglizhenca dhe mosrespektimi i afataeve ligjore në procesin e vlerësimit të projekteve të ndërtimit si QKMF Drenas.

Bazuar në ftesën e kryesuesit të Komisionit, me datë 19/10/2023, ora 10:00 është mbajtur takimi i parë i komisionit, lidhur me shqyrtimin e shkeljes disiplinore. Komisioni pas shqyrtimit të shkresës nr.prot. 05-6098 të datës 02/10/2023 për inicim të procedurës disiplinore, ka vendosur që të kërkohej nga inicuesi i procedurës disiplinore dhe që të përgatitet një deklaratë me shkrim dhe dëshmitë lidhur me përgjegjësinë e për vonesat e procedimit të prokurimit dhe të specifikohen në detaje pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore. Me datë 30/10/2023, Komisioni ka ftuar në seancë disiplinore dhe ka marrë deklaratë për të gjitha pikat e shkeljeve të pretenduara disiplinore.

Komisioni, duke pasur parasysh faktet dhe dëshmitë, konstaton se me datë 29/09/2023 është paraqitur në vendin e punës i veshur me gjinse, që bie në kundërshtim me Nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe normat e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2008 për veshjen dhe Paraqitjen e Nëpunësve Civil, nenin 4 paragrafi x. Ndërsa lidhur me neglizhencën dhe mosrespektimin e afatave ligjore në procesin e vlerësimit të projekteve të ndërtimit si QKMF Drenas, komisioni nuk ka mundur të kontestojë përgjegjësinë individuale të i cili ka neglizhuar procedurën apo është ftuar në takim lidhur me vlerësimin e lëndës dhe ka munguar apo kundërshtuar mbajtjen e takimeve.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër Nr.01/XI/2023 i datës 02.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, masës disiplinore “Ndalimi i njëzet për qind (20%) të pagës bazë për një periudhë katër (4) muaj”, më datë 09.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6952/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa Këshilli më datë 22.11.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6952/2023 të datës 09.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendim i Qeverisë me numër Nr.02/50 i datës 23.12.2021; Vendim me numër Nr.01/XI/2023 i datës 02.11.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë; Dëshmi foto e ankuesit me sako; Deklaratë nga A.M. i datës 02.11.2023; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore me numër 05-6098 i datës 02.10.2023; E-mail nga N.B. për B.M. i datës 29.09.2023; Akt



Emërim i A.Th. me Nr.111 i datës 26.11.2013; Vendim i Qeverisë me Nr.10/109 i datës 23.11.2022; Autorizim nga A.Th. për avokatin H.S. i datës 03.11.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 16.11.2023; Përgjigje në ankesë i datës 22.11.2023; E-mail nga H.S. për A.M. i datës 16.11.2023; Autorizim i konkursit nga DASHC për pozitën "Zyrtar i Lart i Prokurimit" i datës 28.01.2020; Raporti i prezencës në punë i A.Th. i datës 29.09.2023; E-mail nga H.S. për A.M. i datës 20.11.2023; E-mail nga B.M. për M.S. i datës 19.10.2023; E-mail nga M.S. për B.M. i datës 19.10.2023; E-mail nga A.M. për M.S. i datës 18.10.2023; E-mail nga A.M. për M.S. etj. i datës 11.10.2023; E-mail nga B.M. për A.Th. i datës 27.04.2023; Kërkesë-tenderim për shkrehje interesi në realizimin e projektit "Ndërtimi i QKMF Drenas" me numër 05-2277 i datës 13.04.2023; Njoftim për kontrat M.SH.; Procesverbal i hapjes së aplikacioneve; Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave me numër protokolli 05-4661 i datës 01.08.2023; E-mail nga A.Th. për B.M. i datës 17.10.2023; Raporti i vlerësimit të aplikacioneve M.SH. lista e ngushtë i datës 22.08.2023; Rregullore Nr.001/2022 për Prokurim Publik i datës 20.10.2022; E-mail nga B.M. për A.Th. etj. i datës 17.10.2023; E-mail nga G.K. për T.K. etj. i datës 12.10.2023; E-mail nga B.M. për G.K. etj. i datës 13.09.2023; E-mail nga T.K. për B.M. i datës 13.09.2023; E-mail nga B.M. për T.K. i datës 07.09.2023; E-mail nga B.M. për A.Th. etj. i datës 01.09.2023; E-mail nga N.B. për B.M. etj. i datës 07.09.2023; Email nga B.M. për T.K. etj. i datës 07.09.2023; E-mail nga B.M. për A.Th. etj. i datës 29.09.2023; E-mail nga B.M. për T.K. etj. i datës 19.09.2023; E-mail nga F.V. për B.M. i datës 19.09.2023; E-mail nga B.M. për G.K. etj. i datës 13.09.2023; E-mail nga T.K. për B.M. i datës 13.09.2023; E-mail nga B.M. për T.K. etj. i datës 07.09.2023; E-mail nga B.M. për A.Th. etj. i datës 01.09.2023; E-mail nga H.S. për A.M. i datës 20.11.2023; E-mail nga A.Th. për M.S. i datës 24.10.2023; E-mail nga H.S. për A.M. i datës 20.04.2023; E-mail nga N.B. për A.Th. i datës 19.04.2023; Procesverbal i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë i datës 30.10.2023; E-mail nga G.K. për T.K. etj. i datës 12.10.2023; E-mail nga T.K. për A.Th. i datës 02.10.2023; E-mail nga H.S. për C.Z. i datës 22.11.2023; E-mail nga C.Z. për A.M. i datës 21.11.2023; E-mail nga A.M. për C.Z. i datës 21.11.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht provave të administruara, konstaton se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Prokurimit" në Departamentin e Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Akt Emërimit me numër Nr-111 të datës 26.11.2013.

Me datë 29.09.2023 Sekretari i Përgjithshëm përmes e-mailit i drejtohet z. B.M. me titull vërejtje dhe kërkesë ku i drejtohet: *I nderuar koleg Eshtë shqetësuese mosdisiplina dhe performanca e dobët e divizionit të prokurimit! Shumë herë radhazi ju kam kërkuar vëmendjen tuaj në cilësi të Zëvendësuesit të udhëheqësit të divizionit të prokurimit, lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore në divizionin e prokurimit. Për të satën herë brenda viti shof zyrtarë tuaj të cilët vishen në shpërputhje me kodin e veshjes dhe ju nuk merrni veprime ndaj vartësve tuaj të drejtpërdrejt. Sot konkretisht në orën 09:00 të mëngjesit, vartësi juaj zoti ishte në byfe dhe ka të veshura "farmerka"! Nëse nuk janë të gatshëm eventualisht të dëshmojnë punonjësit e kafeterisë dhe zoti me të cilin ishin ulur në kafiteri zoti dëshmit mund të mirren nga kamerat e sigurisë! Juve ju shqiptoj vërejtje, ndërsa për vartësinë tuaj për shkak të shkeljes së përsëritur të iniconi procedurë disiplinore në përputhje me ligjin e zyrtarëve publik! Po ju rikujtoj se në kuadër të performancës së divizionit tuaj ndër të tjera është shqetësuese mosrespektimi i afateve ligjore e në veçanti në këtë korrespondencë ju tërheqë vërejtjen për vonesat në procesin e vlerësimit të projektit të ndërtimit si QKMF Istog dhe QKMF Drenas. Mos*

respektimi i hierarkisë është tipike për divizionin tuaj por edhe mos prezenca në punë e zyrtarëve tuaj shumicën e kohës e me këtë edhe vonesat në shumë aktivitete të divizionit të prokurimit.

Me datë 02.10.2023 me numër protokoll 05-6098 Zv. Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit ka bërë kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore me arsyetimin se: *Të nderuar/a duke u bazuar në kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm Dr. N.B. dërguar përmes e-mailit të datës 29.09.2023 ora 9:26, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj me arsyetimin e potencuar me shkrim ndër të tjera se: Sot konkretisht në orën 09:00 të mëngjesit, vartësi juaj zoti ishte në byfe dhe ka të veshura 'farmerka'! Nëse nuk janë të gatshëm eventualisht të dëshmojnë punonjësit e kafeterisë dhe me të cilin ishin ulur në kafiteri zoti dëshmit mund të mirren nga kamerat e sigurisë! Gjithashtu janë evidente vonesat në procesin e vlerësimit të projekteve të ndërtimit si QKMF Istog dhe QKMF Drenas, siç është potencuar në e-mailin e lartcekur nga SP. Kërkoj nga komisioni disiplinor në MSH të zhvilloj procedurat disiplinore ndaj konform dispozitave ligjore në fuqi.*

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në shkresën me nr.prot.05-6098 datë 02.10.2023 të Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit, lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit "Zyrtar i Prokurimit", në pajtim me nenin 55, 56, 57, 58, 59, 60 dhe 61 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.04/2008 për Veshjen dhe Paraqitjen e Nëpunësve Civil. Pas konstatimit se ka kryer shkelje të rëndë sipas Nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Normat e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2008 për Veshjen dhe Paraqitjen e Nëpunësve Civil neni 4 paragrafi x shkelje e përsëritur ng Bazuar në nenin 57 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1, ka nxjerr vendim me numër Nr.01/XI/2023 të datës 02.11.2023 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi i njëzet për qind (20%) të pagës bazë për një periudhë katër (4) muaj".

Ankuesi, kundër Vendimit me numër Nr.01/XI/2023 i datës 02.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, masës disiplinore "Ndalimi i njëzet për qind (20%) të pagës bazë për një periudhë katër (4) muaj", më datë 09.11.2023 ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor që të anulohet Vendimi me numër Nr.01/XI/2023 i datës 02.11.2023 dhe ti kompensohet diferenca e pagës prej 20% të pagës bazë ankuesit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 56 paragrafit 4 me të cilin është përcaktuar se: 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të

zbatim të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Kolegji i Këshillit po ashtu ka konstatuar se edhe Rregullorja (QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është shfuqizuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër Nr.10/109 të datës 23.11.2022. Si rrjedhojë e kësaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se masa disiplinore është dhënë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.


Andaj bazuar në elaborimin më lart Kolegji ka konstatuar se me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.01/XI/2023 i datës 02.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, masës disiplinore *“Ndalimi i njëzet për qind (20%) të pagës bazë për një periudhë katër (4) muaj”* mbi një akt i cili nuk është në fuqi, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 52 paragrafin 1 dhe nën paragrafin 1.3 dhe 1.5 të këtij ligji.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1398/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokati;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.